

Faktet dhe argumentet:

Ne, Operatori Ekonomik FutureBITS SH.P.K., si palë me interes kundërshtojmë Vendimin e Autoritetit Kontraktues Posta e Kosovës sh.a. të datës 10.07.2026, me të cilin është refuzuar si e pabazuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 07.07.2026.

Kërkojmë nga OSHP: anulimin e vendimit të dhënies së kontratës, si dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim, duke u zbatuar ekskluzivisht kriteret dhe matrica e vlerësimit të paracaktuara në Dosjen e Tenderit (**Aneksi 1 dhe Aneksi 6**), pa asnjë kriter shtesë jashtë dosjes. Pretendojmë se vlersimi nuk bë sipas neneve **1, 7, 59 dhe 60 të LPP-së**, sepse:

Neni 1	Qëllimi i Ligjit	Rekomandimi për kontratë i një oferte 35% më të shtrenjtë, pa arsytim të mjaftueshëm teknik, cenon shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe të drejtë të fondeve publike.
Neni 7	Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi	Elemente identike ose superiore të ofertës sonë (siguria, koha e reagimit, organizimi i mbështetjes) u vlerësuan me pikë dukshëm më të ulëta se te operatori i rekomanduar, pa arsytim teknik të verifikueshëm.
Neni 7.6 (iv-v)	Kriteret e paracaktuara	Komisioni aplikoi kriteret (governance, quality gates, acceptance criteria, risk management, provueshmëri praktike, retention) që nuk janë saktësuar në Dosjen e Tenderit të ndaluar shprehimisht nga neni 7.6.(v).
Neni 59	Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve	Vlerësimi nuk u krye rreptësisht sipas kriterëve dhe matricës së paracaktuar në Aneksin 6, por sipas standardeve të pashpallura.
Neni 60	Kriteret për Dhënien e Kontratës	Kontrata nuk iu dha ofertës ekonomikisht më të favorshme sipas kriterëve të paracaktuara; rezultati final nuk pasqyron zbatimin korrekt të Aneksit 6.

Ankesa mbështetet në dispozitat e LPP-së, të cilat citohen:

Neni 1 Qëllimi i Ligjit

“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike...”

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

7.1 Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

7.2 Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që... diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

7.6...që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies...

Neni 7.6 (v) është dispozita qendrore e kësaj anese: ai ndalon shprehimisht përdorimin e çdo kriteri që nuk është saktësuar në Dosjen e Tenderit gjatë vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Ky nen kërkon që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të kryhet në mënyrë objektive dhe rreptësisht sipas kriterëve e nënkriterëve të paracaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Aneksin 6.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Ky nen përcakton se kontrata i jepet ofertës ekonomikisht më të favorshme, e vlerësuar sipas kriterëve dhe peshave të paracaktuara në Dosjen e Tenderit. Çdo devijim nga këto kriteret e bën dhënien e kontratës të kundërligjshme.

Oferta jonë ishte e plotë, e përgjegjshme dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit:

Oferta financiare: 76,854.82 EUR me TVSH oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme (30 nga 30 pikë).

Metodologjia: e detajuar, e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse sipas Aneksit 1 (Seksioni 21).

Afati i implementimit: 45 ditë kalendarike — tre herë më i shpejtë se afati maksimal i lejuar prej 6 muajsh.

Mbështetja pas implementimit: 12 muaj — dyfishi i minimumit të kërkuar.

Rezultati i vlerësimit:

Ne si FutureBITS u vlerësua me 71.00 pikë, ndërsa operatori i rekomanduar për kontratë mori 81.77, derisa oferta jonë është rreth 35% më e lirë se oferta e operatorit të rekomanduar. Krahasoni i pikëve për secilin nën-kriter është si vijon:

Nr.	Nën-kriteri	Maks.	FutureBITS	OE i rekomanduar	Dif.
1	Çmimi	30	30.00	19.54	+10.46
2	Metodologjia e punës	20	10	20	-10
3	Afati i implementimit	4	4	3.23	+0.77
4	Plani i implementimit	6	3	6	-3
5	Siguria e sistemit	8	5	8	-3
6	Backup dhe rikuperimi	6	5	5	0
7	Integrimi me sisteme të tjera	6	5	6	-1
8	Kohëzgjatja e mbështetjes	9	3	3	0
9	Koha e reagimit për incidente	8	5	8	-3
10	Mënyra dhe organizimi i mbështetjes	3	1	3	-2
	TOTALI	100	71.00	81.77	-10.77

Nga tabela vërehet se FutureBITS ka epërsi vendimtare të çmimi dhe të afati, ndërsa humbjet e pikëve përqendrohen pikërisht te kriteret cilësore ku dokumentacioni ynë është të paktën i barabartë ose superior ndaj operatorit të rekomanduar. Këto humbje analizohen më poshtë.

Për secilin nën-kriter më poshtë krahasojmë ekskluzivisht ofertën tonë me atë të operatorit të rekomanduar, duke e ankoruar çdo pretendim të matrica e Aneksit 6 dhe të neni përkatës i LPP-së. Nën-kriteri i backup-it (5/6) nuk kontestohet, pasi u vlerësua në mënyrë të barabartë me operatorin e rekomanduar (5/6).

1. Mënyra dhe organizimi i mbështetjes: 1/3 kundrejt 3/3

Çka kërkon Aneksi 6 (nënkriteri 5.2.3): niveli më i lartë, E avancuar 3 pikë, përshkruhet fjalë-për-fjalë si: Remote, onsite dhe ekip i dedikuar.

Elementi	FutureBITS	OE i rekomanduar
Remote 24/7 për incidente kritike	PO	PO
Mbështetje onsite	PO (brenda 4 orësh për P1)	PO
Ekip i dedikuar	PO (me role të përgjegjësi)	PO
Helpdesk i dedikuar + monitorim 30-ditor	PO	Jo
Vlerësimi i komisionit (3 anëtarë)	1 - 1 - 1	3 - 3 - 3

Oferta jonë plotëson fjalë për fjalë përshkrimin e nivelit E avancuar (3 pikë) të Aneksit 6 remote, onsite dhe ekipi i dedikuar, madje me elemente shtesë (helpdesk, monitorim i intensifikuar). Megjithatë u vlerësua 1/3, ndërsa operatori i

rekomanduar mori 3/3 me elemente identike. Ky është trajtim i pabarabartë në kundërshtim me nenin 7.1 dhe 7.2 dhe zbatim jokorrekt i matricës në kundërshtim me nenin 59. **Korrigjimi i kërkuar: nga 1 në 3.**

2. Siguria e sistemit: 5/8 kundrejt 8/8

Çka kërkon Aneksi 6 (nënkriteri 4.1): niveli I avancuar (6-8 pikë) përshkruhet si: Qasje e plotë, e detajuar dhe e avancuar ndaj sigurisë së sistemit.

Elementi	FutureBITS	OE i rekomanduar
Autentikim i fortë	JWT + refresh tokens + bllokim	Autentikim i sigurt
Kontroll qasjeje (RBAC)	RBAC me 9 role operative	RBAC
Enkriptim	AES-256 + HTTPS/TLS 1.3	Jo
Mbrojtje web	OWASP Top 10 (CSRF/XSS/SQLi)	Jo
Audit trail i pandryshueshëm	PO	PO
Monitorim	Grafana/Prometheus 24/7	Monitorim aktivitetesh
Standard	ISO/IEC 27001	Jo
Pikët	5 / 8	8 / 8

Oferta jonë përmban çdo element sigurie të përshkruar në ofertën e operatorit të rekomanduar, plus enkriptim AES-256/TLS 1.3, OWASP Top 10 dhe përputhshmëri me ISO/IEC 27001. Objektivisht, dokumentacioni ynë i sigurisë është të paktën i barabartë dhe në disa aspekte superior ndaj atij që mori 8/8. Vlerësimi ynë me 5/8 është i paarsyetuar dhe diskriminues (neni 7.1, 7.2). Për më tepër, AK e arsyeton uljen me kërkesa për nivel operacional të matshëm dhe të provueshëm, një standard që nuk ekziston në Aneksin 1 as në Aneksin 6, ndaj përdorimi i tij ndalohej nga neni 7.6 (v). **Korrigjimi i kërkuar: nga 5 në 8.**

3. Koha e reagimit për incidente: 5/8 kundrejt 8/8

Çka kërkon Aneksi 6 (nënkriteri 5.2.2): niveli Shumë i mirë (8 pikë) përshkruhet si: Kohë reagimi të qarta dhe të favorshme për të tri nivelet e incidenteve.

Elementi	FutureBITS	OE i rekomanduar
Incidente kritike (P1)	reagim nën 2 orë / zgjidhje nën 6 orë	Jo
Incidente të mesme (P2)	reagim nën 4 orë / zgjidhje nën 24 orë	Jo
Incidente të ulëta (P3)	reagim nën 8 orë / zgjidhje nën 72 orë	Jo
Deklarimi i përgjithshëm	SLA e detajuar për 3 nivele + onsite 4h	24/7
Pikët	5 / 8	8 / 8

Aneksi 6 e lidh notën maksimale me kohë të qarta për të tri nivelet. Oferta jonë ofron pikërisht kohë të sakta e të matshme për të tri nivelet (P1/P2/P3), duke plotësuar shprehimisht përshkrimin e nivelit 8. Operatori i rekomanduar mori 8/8 duke deklaruar thjesht 24/7, pa kohë të diferencuara për nivele. Vlerësimi ynë me 5/8 është diskriminues (neni 7.2). AK i shton kriteret si kapacitetet operative dhe provueshmëria e SLA-ve, që nuk figurojnë në Aneksin 6, të ndaluara nga neni 7.6 (v). **Korrigjimi i kërkuar: nga 5 në 8.**

4. Integrimi me sisteme të tjera: 5/6 kundrejt 6/6

Çka kërkon Aneksi 6 (nënkriteri 4.3): niveli I avancuar (5-6 pikë) përshkruhet si: Qasje e qartë, fleksibile dhe e avancuar për integritet me sisteme tjera.

Elementi	FutureBITS	OE i rekomanduar
API / web services	REST API + OAuth2/API Key	API-first, REST API, OAuth2
Model i qëndrueshmërisë	Adapter pattern + Retry + Circuit Breaker	Jo
Njoftime dhe standarde	Webhook + OpenAPI/Swagger + EDI/UPU/ITMATT/EAD + ERP	Jo
Pikët	5 / 6	6 / 6

Oferta jonë paraqet një zgjidhje integrimi më të pasur teknikisht (adapter pattern, retry me backoff, circuit breaker, webhook, versionim API, standardet UPU), e cila i tejkalon kërkesat e Aneksit 6 dhe plotëson nivelin I avancuar. Diferenca 5/6 kundrejt 6/6 është e paarsyetuar dhe në kundërshtim me nenin 7.1. **Korrigjimi i kërkuar: nga 5 në 6.**

5. Metodologjia e punës: 10/20 kundrejt 20/20

Çka kërkon Aneksi 6 (kriteri 2): niveli më i lartë Shumë i mirë (16-20 pikë) përshkruhet si: Metodologji e detajuar, e qartë dhe e avancuar.

Metodologjia jonë (dokumenti i dorëzuar me ofertë) përmban: qasje Agile-Scrum me cikle të verifikueshme; kontroll cilësie me Code Review; testim automatik me mbulim 80% për modulet kritike; testim ngarkese për 500 përdorues; skanim sigurie OWASP ZAP; validim dhe aprovim të detyrueshëm nga AK pas çdo faze; dhe dokumentim paralel me zhvillimin. Këto elemente përbëjnë pikërisht mekanizma të kontrollit të cilësisë dhe të pranimi të rezultateve (quality gates dhe acceptance nëpërmjet aprovimit të AK).

AK e ul notën duke pretenduar mungesë të governance, quality gates, acceptance criteria, risk management dhe change control. Asnjëri prej këtyre termave nuk figuron as në Aneksin 1 as në Aneksin 6 si kërkesë e shpallur; matrica cilësore flet vetëm për metodologji të detajuar, të qartë dhe të avancuar. Aplikimi i këtyre kriterëve të pashpallura ndalohet shprehimisht nga neni 7.6 (v) dhe cenon nenet 59 e 60. Metodologjia jonë plotëson nivelin e detajuar dhe e avancuar. **Korrigjimi i kërkuar: nga 10 në së paku 16.**

6. Plani i implementimit: 3/6 kundrejt 6/6

Çka kërkon Aneksi 6 (nënkriteri 3.2): niveli Shumë i mirë (6 pikë) përshkruhet si: Plan i detajuar, i strukturuar dhe i zbatueshëm.

AK vetë e ka pranuar afatin tonë me pikë maksimale (4/4), çka do të thotë se struktura e fazave është e pranueshme. Plani ynë është i strukturuar në 6 faza me aktivitete, deliverables dhe milestones ditë-pas-dite brenda 45 ditëve. AK e ul notën duke kërkuar varësi, mekanizma kontrolli, menaxhim risku dhe pranim rezultatesh, kriterë që nuk janë të përcaktuara në Aneksin 1 as në Aneksin 6 (neni 7.6). **Korrigjimi i kërkuar: nga 3 në së paku 5.**

Vlerësimi me kriterë jashtë dosjes së tenderit

Vetë Vendimi refuzues Nr. 01-1293/26 e dokumenton se Komisioni vlerësoi ofertën tonë duke kërkuar elemente si governance, quality gates, acceptance criteria, risk management, provueshmëria praktike në mjedis prodhimi, retention, kapacitetet operative dhe provueshmëria e SLA-ve. **Asnjëri prej këtyre termave nuk gjendet në Aneksin 1 (specifikimet teknike të detyrueshme) as në Aneksin 6 (kriteret e vlerësimit).**

Zbatimi i tyre bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 7.6 i cili urdhëron se asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është saktësuar në Dosjen e Tenderit nuk mund të përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, si dhe me nenin 7.6 që kërkon saktësimin paraprak të të gjitha kriterëve dhe peshave. Për pasojë, vlerësimi cilësor është kryer në kundërshtim me nenet 7, 59 dhe 60 të LPP-së.

Oferta jonë e përgjegjshme, me vlerë 76,854.82 EUR me TVSH, është dukshëm më e favorshme financiarisht se oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë, me një diferencë prej rreth 35% në favor të fondeve publike. Rekomandimi për

dhënien e kontratës një oferte me vlerë të konsiderueshme më të lartë, pa një epërsi cilësore reale që ta arsyetonte këtë diferencë, nuk ndërlidhet me përdorimin sa më efikas të fondeve publike dhe, si i tillë, nuk gjen mbështetje në qëllimin e nenit 1 dhe në parimin e ekonomicitetit të nenit 6 të LPP-së.

Rezultati as një rivlerësimi korrekt minimal:

Nëse nën kriteret e kontestuara korrigjohen sipas matricës së Aneksit 6 dhe dokumentacionit tonë, rezultati përfundimtar ndryshon dhe FutureBITS del oferta me pikët më të larta:

Nr.	Nën-kriteri	Maks.	Aktual	I korrigjuar	OE i rekomanduar
1	Çmimi	30	30.00	30.00	19.54
2	Metodologjia e punës	20	10	16	20
3	Afati i implementimit	4	4	4	3.23
4	Plani i implementimit	6	3	5	6
5	Siguria e sistemit	8	5	8	8
6	Backup dhe rikuperimi	6	5	5	5
7	Integrimi me sisteme të tjera	6	5	6	6
8	Kohëzgjatja e mbështetjes	9	3	3	3
9	Koha e reagimit për incidente	8	5	8	8
10	Mënyra dhe organizimi i mbështetjes	3	1	3	3
	TOTALI	100	71.00	88.00	81.77

Me korrigjimin e nën-kritereve ku është konstatuar trajtim i pabarabartë ose aplikim i kritereve jashtë dosjes, FutureBITS arrin 88.00 pikë kundrejt 81.77 pikëve të operatorit të rekomanduar, duke u renditur i pari.

Bazuar në faktet, dëshmitë dhe argumentet e mësipërme, FutureBITS SH.P.K. i kërkon Organit Shqyrtues të Prokurimit:

Ta pranojë ankesën si të bazuar dhe të argumentuar;

Të anulojë vendimin e dhënies së kontratës dhe Vendimin e AK-së të datës 10.07.2026;

Të urdhërojë kthimin e aktivitetit në rivlerësim, duke u aplikuar ekskluzivisht kriteret dhe matrica e Aneksit 1 dhe Aneksit 6, pa asnjë kriter shtesë jashtë dosjes së tenderit;

Të konstatojë shkeljen e neneve 1, 7, 59 dhe 60 të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues.